




Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

MONITORIMI I MEDIAVE GJATË MUAJIT TETOR

Tetor, 2023



PËRMBAJTJA

1	METODOLOGJIA.....	5
2	TË GJETURAT KRYESORE.....	6
3	SHEMBUJT NË GJUHËN SHQIPE	8
4	SHEMBUJT NË GJUHËN SERBE.....	9

MONITORIMI I MEDIAVE GJATË MUAJIT TETOR

1 Koha e monitorimit

1 – 31 tetor 2023

2 Fushë veprimi

Çrregullimet e informacionit në internet dhe media sociale: Uebfaqe, portalet online të lajmeve, Facebook, Youtube, TikTok dhe Instagram.

3 Mostra

Gjuhën shqipe dhe serbe

4 Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i crregullimeve në mediat online në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, rreth zhvillimeve/ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë muajit tetor në Kosovë.

Ky raport është përgatitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Mbëlueshmëria dhe kuptueshmëria e çrregullimit të informacionit në Kosovë”, që mbështetet nga NDI dhe USAID në Kosovë. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NDI Kosovo.

2. METODOLOGJIA

Qëllimi i Institutit Demokraci për zhvillim (D4D), është identifikimi dhe luftimi i lajmeve me çrregullim të informacionit, trend ky në rritje i përhapjes së lajmeve me çrregullim të informacionit.

Instituti D4D, ka bërë monitorimin e mediave online dhe atyre sociale për të identifikuar lajmet/artikujt të cilat përmbajnë çrregullime të informacionit, përmes një platforme monitoruese, duke klasifikuar artikujt në bazë të kategorive: zhvillimet në veri; dialogu Kosovë-Serbi; gjuha e urrejtjes; dhuna online ndaj grave; ndasitë politike dhe ndikimi ndërkombëtar. Mediat online të cilat janë monitoruar përmes platformes kanë qenë mbi 100 media online vendore, të rajonit dhe ndërkombëtare, të selektuara në një platformë monitoruese. Monitorimi dhe analizimi i artikujve me çrregullim të informacionit është bërë paralelisht në dy mostra: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

Përzgjedhja e shembujve nga të dyja mostrat është bërë duke u bazuar në përmbajtjen e artikullit i cili ka shpërndarë: dezinformata, manipulim të fakteve, përmbajtje të paverifikuara, lajm të pavërtetë, teori konspirative, clickbait, gjuhë të urrejtjes, gjuhë ofenduese, gjuhë kërcënuese, nxitëse, artikuj me tituj tendencioz, dhe raportim të njëanshëm. Kategoritë të cilat kanë mbizotëruar në mostrën e gjuhes shqipe kane qene: zhvillimet ne veri, dialogu Kosovë-Serbi dhe polarizimi politik, kurse në mostrën në gjuhën serbe mbetet dialogu Kosovë-Serbi dhe zhvillimet në veri. Në të dy mostrat mbizoterojnë narrativa të paverifikuara dhe jo të bazuara në fakte pas sulmit në Banjskë, më 24 shtator . Gjatë kësaj periudhe janë analizuar rreth 1000 artikuj në gjuhën shqipe, ku prej të cilave rreth 100 prej tyre kanë rezultuar të jenë me çrregullim të informacionit, ndërsa në mostrën në gjuhën serbe janë analizuar rreth 800 artikuj, ku prej të cilave 123 kanë rezultuar me çrregullim të informacionit.

3.TË GJETURAT KRYESORE

- Teori konspirative-gjatë monitorimit të lajmeve në mostrën në gjuhën shqipe, janë vërejtur narrativa konspirative, nga portalet online, në lidhje me tensionet në Banjskë dhe ngjarjeve që mund të ndodhin pas tensioneve të shtatorit. Aludimet konspirative në shumicën e rasteve kanë përmbajtje negative të cilat mund të përhapin pasiguri të lexuesit, dhe bazohen në mendime subjektive të cilat citohen dhe përdoren në titull dhe në përmbajtje.
- Deepfake- gjatë muajit tetor, ka pasur edhe narrativa të rrejshme në portalet online përmes videove të gjeneruara nga inteligjenca artificiale (deepfake). Në TikTok ka qarkulluar një video e gjeneruar nga inteligjenca artificiale. Në video shihet Kryeminsitri i Kosovës, Albin Kurti, ku shihet duke folur arabisht gjatë një interviste.
- Keqinterpretim i informacionit, siç ishte fjalimi i Presidentit të Francës, Emanuel Macron është edhe një ndër lajmet më të shkruara të muajit tetor. Për shkak të një gabimi në përkthim, mediat në Kosovë dhe Shqipëri raportuan se liberalizimi i vizave për Kosovën u “pezulla”. Ky lajm është shpërndarë nga 38 media vendore dhe 2 media serbe.
- Në mostrën në gjuhën serbe vazhdojnë narrativat e rrejshme kundër figurave politike në Kosovë, të cilat barten nga persona zyrtarë të sferës politike në Serbi. më e përhapur në mostrën në gjuhën serbe vazhdon të jetë “regjimi dhe spastrimi etnik” i Kurtit ndaj serbëve në veri. Supozimet në fjalë, krijojnë përshtypjen e gabuar të situatës në Kosovë, dhe krijohet një realitet tjetër për qytetarët në serbi apo për lexuesit e mediave serbe.
- Samiti në Spanjë po ashtu ishte temë kryesore në mediat serbe, ku të ftuar ishin liderë nga vendet e Evropës, përfshirë këtu edhe nga Kosova dhe Serbia. Pas deklaratës së Presidentes Osmani se nuk do të takohej me Presidentin Vucic nëse BE nuk vendos sanksione për sulmin e 24 shtatorit në Banjskë. Këtë deklaratë mediat në serbi e konsideruan si hipokrizi nga ana e Presidentes Osmani, duke thënë se ajo ka udhëtuar në Spanjë me pasaportë serbe pa probleme dhe pa kushte. Një informatë e tillë keqinformon lexuesit serb për Kosovë.

[[1] Deepfake është video e një personi në të cilën fytyra, zëri ose trupi i tij është ndryshuar në mënyrë dixhitale në mënyrë që të duken si dikush tjetër, i përdorur zakonisht me qëllim të keq ose për të përhapur informacion të pavërtetë. Source: Oxford dictionary

4. SHEMBUJT NË GJUHËN SHQIPE

Konspiracionisti kosovar: Një luftë e ashpër Kosovë – Serbi do të ndodhë në nëntor dhe dhjetor



Aranit Sllamniku, një studiues i teorieve konspirative dhe një parashikim të frikshëm mbi atë se çfarë po ndodh në veriun e Kosovës.

Portali i lajmeve Lajmi.net ka publikuar një artikull me titull: **“Konspiracionisti kosovar: Një luftë e ashpër Kosovë-Serbi do të ndodhë në dhjetor”**, në këtë artikull, ka përmbajtje konspirative ku thuhet se një luftë në mes të Kosovës dhe Serbisë do të ndodhë nga mesi i muajit nëntor dhe dhjetor të këtij viti, 2023. pa argumente faktike po publikohet një lajm që cilësohet si i pavërtetë dhe kjo mund të shpërndajë pasiguri te qytetarët.

Ky lajm ka arritur të grumbullojë 96 ndërveprime, prej të cilave 67 pëlqime, 23 komente dhe 6 shpërndarje.

Portali Albanian post ka publikuar një artikull me titull: **“Njësia Speciale Intervenuese (NjSI, FIT) po shqyrton largimin nga radhët e policisë, pakënaqësi me Qeverinë e Kosovës”**. Më tutje në përmbajtje të artikullit thuhet se ky lajm bazohet “në burime brenda kësaj njësie”, mirëpo nuk ka ndonjë shpjegim më të qartë për vërtetësinë e lajmit. D4D ka hulumtuar për ndonjë komunikatë nga Policia e Kosovës ku mund të verifikohet ky lajm, por një komunikatë e tillë nuk është bërë nga Policia e Kosovës dhe as nga Qeveria e Kosovës.

3 portale kanë raportuar, 2 prej të cilave mund ta kenë marrë lajmin nga Albanian Post sepse janë publikuar më vonë në të njëjtën ditë. Ky lajm gjithsej ka grumbulluar 753 ndërveprime, prej të cilave janë 554 pëlqime, 180 komente dhe 19 shpërndarje.





Një llogari në TikTok me emrin Kanalstatat e Kosovës ka publikuar një video ku shihet Kryeministri Kurti gjatë një interviste duke folur në gjuhën arabe. Kjo video, e cila u bë virale pasi që pati një shikueshmëri të lartë, është prodhim i inteligjencës artificiale e cila mund të gjenerojë përmbajtje që nuk janë të vërteta. Kjo cilësohet si Deepfake, në rastin e vërtetë Kryeministri Kurti ishte duke dhënë një intervistë për një media të huaj në gjuhën angleze.

Kjo video ka marrë 5,625 pëlqime, 483 komente, 2183 shpërndarje, dhe është ruajtur si video nga 1574 përdorues të TikTok-ut.



Gjatë një fjalimi të Presidenti Francez, Emanuel Macron, në një konferencë për shtyp në Tiranë, ka folur për tensionet në veri dhe liberalizimin e vizave për Kosovën. Përkthimi në gjuhën shqipe i fjalimit të presidenti Macron nuk ishte i saktë, mediat kanë raportuar gjerësisht mbi keqinterpretimin e përkthimit stimulant të fjalimit të Presidentit Francez Macron. Përkthimi i fjalimit të Presidentit Macron ishte si ne vijim:

“E them me qartësi ju kemi besuar për vizat, çështja është pezulluar nga ana e Francës sepse ka të bëjë me respekt për fjalën e dhënë dhe fjala nuk po mbahet. Pres që palët të angazhohen që të ecin përpara dhe është kushti i paqes në të gjithë zonën”.

Ky është përkthimi zyrtar i publikuar në faqen zyrtare të Kryeministrit të Shqipërisë. Duke iu referuar ndodhjeve të fundit në veri, Macron ka shprehur se fjala e dhënë nga dy shtetet për stabilizimin e situatës në veri nuk po mbahet, por nuk ka thënë si pasojë do të pezullohen vizat.

Si rrjedhojë, shumë media në Kosovë dhe Shqipëri, duke përfshirë edhe rrjetet sociale dhe portalet online, kanë shpërndarë lajmin se Franca pezullon vizat për Kosovën. Disa nga mediat e kanë korrigjuar lajmin e disa të tjera kanë vazhduar ta mbajnë lajmin e keqinterpretuar. Ndikimi i një informate me përmbajtje të çrregullimit të informacionit vërehet në këtë rast ku edhe figura publike në Kosovë reagojnë ashpër kundrejt qeverisë së Kosovës për “pezullimin e vizave”

6. SHEMBUJT NË GJUHËN SERBE

Portali serb Novosti ka publikuar një artikull me këtë titull:

“AJO KËRKOI SANKSIONE PËR SERBINË, DHE HYRI ME PASAPORTË SERBE NË SPANJË: Presidentja false tregoi edhe një herë sa hipokrite është” ky artikull shkruan se si Presidentja e Kosovës kërkon sanksione ndaj Serbisë, para se të ketë bisedime me Presidentin Serb Vuçiq, në Grenada të Spanjës, ku të dy liderët ishin të ftuar. Më pas vijon duke cilësuar këtë deklaratë të Presidentes Osmani si hipokrizi dhe duke thënë se ajo vet ka udhëtuar me pasaportë serbe, duke u bazuar në faktin se Spanja nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, gjë që do të nënkuptonte edhe mosnjohjen e pasaportës Kosovare. Mirëpo këshilltarja e presidentes Osmani, Egnesa Vitia i është pergjigjur kësaj dileme se si udhëton një qytetar në Spanjë me pasaportë të Republikës së Kosovës.



“Presidentja Osmani ka udhëtu me pasaportë të Republikës së Kosovës, si dhe nuk posedon asnjë pasaportë tjetër. Me vize të lëshuar nga ambasada e Spanjes në Shkup, kurse udhëtimi nepërmjet Vjenës. Te gjitha me pasaportë të Republikës së Kosovës. Nuk është hera e parë që kjo procedure ndiqet per qytetare te RKS.”

Më poshtë, ky artikull shkruan se edhe figura të tjera politike në Kosovë si Albin Kurti, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli gjithashtu posedojnë pasaporta Serbe. Ky artikull përmban çrregullim te informacionit për shpërndarje të një informate të pa vërtetë për Presidenten Osmani, ky lajm cilësohet jo i vërtetë dhe keqinformon qytetarët serb në Serbi se figurat publike të Kosovës duhet të kenë pasaporta serbe për të udhëtuar në vende si Spanja, të cilat nuk e njohin Kosovën si shtet të pavarur. Ky artikull ka grumbulluar 134 ndërveprime *ashim Thaçi, Kadri Veselji dhe shumë politikanë të tjerë nga Prishtina.*”



Mediumi serb Naslovina ka publikuar një artikull: **VUÇIC PËR CNN: “Nuk kemi nevojë për konflikt me NATO-n, na intereson vetëm siguria e serbëve – Kurti dëshiron të vazhdojë spastrimin etnik”** Artikulli jep informata për intervistën e Presidentit të Serbisë Vuçiq për televizionin CNN, ku presidenti Vuçiq ka vazhduar narrativën se Kryeministri Kurti po bën “spastrim etnik” ndaj serbëve në veri të Kosovës, dhe fasjon shtete perëndimore se po mbajnë anën e Kurtit. “Ata bënë spastrim gradual etnik, që nga ardhja e Kurtit në pushtet ka 10 për qind më pak serbë në Kosovë dhe Metohi, ka pasur më shumë se 420 sulme ndaj popullit tonë në veri të Kosovës dhe Metohisë”- tha Vuçiq për CNN.

Presidenti Vuçiq vazhdon me fajësimin dhe akuzat ndaj Kryeministrit Kurti nëpër mediat serbe dhe ndërkombëtare. Në anën tjetër, mediat serbe vazhdojnë të shpërndajnë të njejtat narrativa sikurse Presidenti Vuçiq, duke nxitur ndasitë ndër-etnike dhe duke portretizuar shqiptarët si agresorë ndaj komuniteteve pakicë, veçanërisht ndaj komunitetit serb në Kosovë. Këto lajme cilësohen si jo të vërteta dhe të një-anshme, me përmbajtje të pa bazuara në fakte. Ky lajm ka grumbulluar 353 ndërveprime, ku prej tyre 38 pëlqime, 133 komente dhe 182 shpërndarje.

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cilamerr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendimmarrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efektive, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikatspecifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik. Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi viziton faqen tonë elektronike:

www.d4d-ks.org

Mbështetur nga:

